

Vendim nr. 284 datë 25.11.2024

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga: Holta Zaçaj, Kryetare, Marsida Xhaferllari, Fiona Papajorgji, Sandër Beci, Genti Ibrahim, Marjana Semini, Ilir Toska, anëtarë, në datën 25.11.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 5 (J) 2024 të Regjistrisë Themeltar, që u përket:

KËRKUES: **JAMARBËR MALLTEZI,**
SHOQËRIA “STUDIO PUSTINA” SH.P.K.,
përfaqësuar nga avokat Klodjan Skënderaj, me prokurë.

OBJEKTI: **Shfuqizimi i vendimeve nr. 449, datë 16.11.2023 të Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 173, datë 22.12.2023 të Gjykatës së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar; nr. 00-2024-666, datë 11.04.2024 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.**

BAZA LIGJORE: **Nenet 17, 36, 37, 41, 42, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); nenet 6 dhe 8 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*KEDNJ*); Konventa e Budapestit, e ratifikuar me ligjin nr. 8888, datë 25.04.2022; Kodi i Procedurës Penale (*KPP*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).**

Mbledhja e Gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese (*Mbledhja e Gjyqtarëve*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Ilir Toska, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Prokuroria e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar (*Prokuroria e Posaçme*), mbi bazën e një kallëzimi për kryerjen e disa veprave penale nga funksionarë të lartë shtetërorë, në vitin 2020 ka regjistruar procedimin penal nr. 287, për veprën penale “Pastrimi i produkteve të veprës penale apo veprimtarisë kriminale”, të parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal (KP). Objekti i kallëzimit dhe i hetimit në vijim lidhet me procesin e kthimit në favor të ish-pronarëve të një sipërfaqeje trualli që i përkiste Klubit Sportiv Partizani (në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes) dhe Klubit shumësportesh Partizani (në varësi të Ministrisë së Kulturës), procedurat e privatizimit të terreneve sportive dhe objekteve të këtyre klubeve sportive dhe, në vijim, me ndryshimin e destinacionit e, më pas, me zhvillimin e kësaj prone.

2. Gjatë hetimeve paraprake ka rezultuar se zhvillimi i pronës është bërë nga shoqëria “Homeplan” sh.p.k., veprimet financiare të së cilës në lidhje me këtë aktivitet janë kryer nga shoqëria “Studio Pustina” sh.p.k. (*kërkuesja*) me ortake të vetme dhe administratore shtetasen A.P. Nisur nga kjo, me vendimin e datës 28.04.2023, mbështetur në nenin 208 e vijues të KPP-së, prokurorët e çështjes kanë urdhëruar sekuestrimin në ambientet e kërkueses të të gjitha dokumenteve që kanë lidhje me shoqërinë “Homeplan” sh.p.k., si dhe të kompjuterit në të cilin mbahen të dhënat e kësaj të fundit, si dhe çdo gjë tjetër që vlerësohet me rëndësi për hetimin dhe që ofron të dhëna mbi faktin objekt hetimi. Ky vendim është zbatuar po në të njëjtën ditë nga oficerët e Policisë Gjyqësore (*OPGJ*) pranë Prokurorisë së Posaçme.

3. Në vijim të hetimeve, në datën 02.10.2023, prokurorët e çështjes kanë shënuar në regjistrin e njoftimit të veprave penale edhe emrin e shtetasit Jamarbër Malltezi (*kërkuesi*), si të dyshuar për kryerjen e veprave penale “Korrupsioni pasiv i funksionarëve të lartë shtetërorë ose të zgjedhurve vendorë”, në bashkëpunim, dhe “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, të parashikuara nga nenet 260 e 25 dhe 287, paragrafi 2, të KP-së, kurse me vendimin nr. 112, datë 20.10.2023 të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Shkallës së Parë*) ndaj personave nën hetim, përfshirë edhe për kërkuesin Jamarbër Malltezi, janë caktuar masat e sigurimit personal me karakter shtrëngues.

4. Ndërkohë, pas kërkesës së prokurorëve të çështjes, me vendimin nr. 420, datë 21.10.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka autorizuar kontrollin e disa banesave/vendeve, ndër to të banesës ku jeton kërkuesi Jamarbër Malltezi, si dhe të zyrës së kërkueses, shoqëria “Studio

Pustina” sh.p.k., përveç edhe kontrollin personal të kërkuesit Jamarbër Malltezi, duke disponuar edhe për sekuestrimin e sendeve të gjetura gjatë kontrollit të banesave që përbëjnë provë materiale.

5. Në ekzekutim të vendimeve të mësipërme, sipas procesverbalit të datës 21.10.2023 “Për sekuestrimin e sendeve”, pas kontrollit personal, bazuar në nenin 300, pika 2, të KPP-së, OPGJ-të i kanë sekuestruar kërkuesit Jamarbër Malltezi sendin në posedim të tij, konkretisht aparat celular të markës *Iphone* 14. Referuar procesverbalit, ky send është vlerësuar si provë materiale ose send i lidhur me një vepër penale, për nevoja të procedimit penal nr. 287 të vitit 2020, i cili duhet sekuestruar, meqenëse ka rrezik të ndryshojë ose të humbasë. Me vendimin e datës 23.10.2023 prokurorët e çështjes, bazuar në nenin 301 të KPP-së, kanë vendosur të vleftësojnë të ligjshëm sekuestron për këtë send, duke vlerësuar se ai është i nevojshëm për hetimin, pasi në të mund të gjenden të dhëna me rëndësi për hetimin, siç mund të jenë komunikimi me bashkëpunëtorë të mundshëm, dokumente etj., ndërsa ekziston rreziku se ai mund të ndryshojë ose humbasë.

6. Për sa i përket kërkueses tjetër, shoqërisë “Studio Pustina” sh.p.k., në zbatim të vendimit të mësipërm të GJKKO-së së Shkallës së Parë, sipas procesverbalit të datës 22.10.2023, pas kontrollit të mjediseve të zyrës së saj, bazuar në nenin 300, pika 2, të KPP-së, krahas disa dokumenteve, OPGJ-të kanë sekuestruar edhe disa sende të gjetura (ose dorëzuara) nga shtetasja A.P., konkretisht: katër *flash*; një telefon celular i markës *BlackBerry*; një CD; një njësi qendrore *Dell*; dy pajisje *hard disc*; një laptop *Hp*; një laptop *Fujitsu*; një njësi qendrore PC. Me vendimin e datës 23.10.2023 prokurorët e çështjes kanë vleftësuar të ligjshëm sekuestrimin e dokumenteve dhe sendeve nga OPGJ-të, duke vlerësuar se janë ndodhur në kushtet kur ekzistonte rreziku që ato të ndryshonin ose humbnin, ndërsa prokurori nuk mund të ndërhynte në mënyrë urgjente.

7. Në datën 08.11.2023 kërkuesi Jamarbër Malltezi ka paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimit të datës 23.10.2023 të Prokurorisë së Posaçme “Për vleftësimin si të ligjshëm të sendeve të sekuestruara”, në lidhje me sekuestrimin e aparatit celular në zotërim të tij. Po në të njëjtën datë, edhe kërkuesja shoqëria “Studio Pustina” sh.p.k. ka paraqitur ankim në gjykatë ndaj vendimit të datës 23.10.2023 të Prokurorisë së Posaçme “Për vleftësimin si të ligjshëm të sendeve të sekuestruara”, për sa i përket sekuestrimit të pajisjeve dhe sistemeve kompjuterike në ambientet e saj.

8. Ankimet e kërkuesve janë bashkuar, duke u shqyrtuar në një gjykim të vetëm dhe me vendimin nr. 449, datë 16.11.2023, GJKKO-ja e Shkallës së Parë ka vendosur rrëzimin e tyre si të pambështetura në prova dhe në ligj. Sipas asaj gjykate, sekuestrimi i dokumenteve, sendeve dhe i

aparateve celulare është kryer në zbatim të parashikimeve të nenit 208 të KPP-së. Ajo gjykatë e ka analizuar çështjen në këndvështrim të nenit 1 të Protokollit nr. 1 të KEDNJ-së, që sanksionon të drejtën e pronës private, si dhe të neneve 208 e 208/a të KPP-së, duke vlerësuar se nisur nga fakti që kërkuesi Jamarbër Malltezi dyshohet për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 287 i KP-së, e cila nuk përfshihet në rrethin e veprave penale që lidhen me teknologjinë e informacionit, referimi i duhur është në rregullin e përgjithshëm të nenit 208 të KPP-së dhe jo te neni 208/a i tij. Po sipas saj, ndalimi i përkohshëm i zotërimit/përdorimit të sendeve të sekuestruara është i justifikuar dhe i domosdoshëm në kuadër të vërtetimit të faktit penal të hetuar, ndërsa ky fakt dyshohet të jetë kryer nëpërmjet transferimit të pasurisë me qëllim për të fshehur ose mbuluar origjinën e saj të paligjshme, të arritura këto përmes transaksioneve të ndryshme financiare, të cilat, potencialisht, mund të evidentohen në sendet/dokumentet e sekuestruara pranë kërkueses “Studio Pustina” sh.p.k., si subjekti që i ka përpiluar ato, nisur nga fakti se ka qenë subjekti që ka mbajtur kontabilitetin e shoqërisë “Homeplan” sh.p.k. Po kështu, sipas gjykatës, ekziston dyshimi i arsyeshëm se edhe në aparatet celulare në përdorim të kërkuesve mund të gjenden të dhëna me rëndësi dhe interes për hetimin, qoftë në kuadër të komunikimeve të realizuara nëpërmjet thirrjeve hyrëse/dalëse, mesazheve, videove, audiove etj., ashtu edhe të çdo dokumenti tjetër elektronik në përmbajtjen e tyre. Gjykata ka vlerësuar se janë të dhënat që do të përftohen nga kryerja e akteve të ekspertimit ato që do të shërbejnë për të konkluduar nëse në këto sende të sekuestruara gjenden të dhëna me interes dhe të domosdoshme për hetimin. Së fundmi, gjykata ka vlerësuar se çështja është në fazën e hetimeve paraprake dhe është detyrim i prokurorit të kryejë veprimet e nevojshme procedurale në kuadër të një hetimi të plotë e shterues dhe se në këto kushte, si dhe duke pasur parasysh se sendet e sekuestruara futen në kategorinë e atyre që duhet të konfiskohen, referuar nenit 36 të KP-së, ato duhet të vazhdojnë të qëndrojnë të sekuestruara deri në përfundim të hetimeve. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur ankim kërkuesit.

9. Me vendimin nr. 173, datë 22.12.2023, Gjykata e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar (*GJKKO e Apelit*) ka vendosur miratimin e vendimit të GJKKO-së së Shkallës së Parë, duke i gjetur të pabazuara shkaqet e ankimit. Sipas GJKKO-së së Apelit, akti i ngutshëm i sekuestrimit nga OPGJ-të i sendeve të luajtshme dhe vendimmarrjet e prokurorit për vleftësimin e ligjshëm të tyre me argumentin se lidhen dhe ofrojnë të dhëna për faktet objekt hetimi, është i bazuar në këndvështrim edhe të së drejtës së pronës, të parashikuar nga Kushtetuta dhe KEDNJ-ja, të standardeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*) në drejtim të ndërhyrjes

në këtë të drejtë, si dhe referuar neneve 208, pika 1, dhe 301 të KPP-së, që kanë të bëjnë me sekuestron provuese dhe nenit 187 të këtij kodi në drejtim të kuptimit që ligji procedural i jep “provës materiale”. Sipas gjykatës, sendet e sekuestruara kanë vlerën e provës materiale, pasi janë objekt i verifikimeve që është duke kryer Prokuroria e Posaçme në funksion të hetimit të procedimit penal dhe se, sipas të dhënave të aktit të ekspertimit, pajisjet *flash drive* dhe telefonat celularë të sekuestruar i janë nënshtruar ekspertimit, duke u futur në procesin e marrjes/nxjerrjes dhe dokumentimit të tyre, në përfundim të të cilit prokurorët e çështjes do të konkludojnë në lidhje me rëndësinë e tyre. Po sipas gjykatës, në përputhje me të drejtën dhe duke vlerësuar qoftë rëndësinë e sekuestrimit, ashtu edhe lidhjen e sendeve me veprat penale objekt hetimi, prokurorët e çështjes kanë vendosur drejt kur kanë miratuar veprimet e ngutshme të OPGJ-ve, pasi verifikimi i të dhënave që gjurmohen ka rëndësi dhe lidhet drejtpërdrejt me sqarimin e rrethanave dhe të fakteve objekt hetimi. Në lidhje me pretendimin e ngritur në ankim për shkeljen e parashikimeve të nenit 208/a të KPP-së dhe për sa i përket zbatimit të vendimit njësuës nr. 147, datë 23.12.2021 të Gjykatës së Lartë, GJKKO-ja e Apelit ka arsyetuar se kjo dispozitë u referohet rregullave të posaçme për sekuestrimin e të dhënave kompjuterike, që nuk është rasti objekt gjykimi. Sipas gjykatës, në të kundërt nga sa pretendohet, referuar edhe nenit 1 të kapitullit I të Konventës “Për krimin në fushën e kibernetikës”, një laptop, një njësi qendrore, një USB, një telefon celular apo disa të tilla, të pandërlidhura në një rrjet/sistem kompjuterik, janë veçse mekanizma të automatizuar apo pajisje elektronike që në kuptim të nenit 187 të KPP-së janë sende që, me të dhënat apo gjurmët që përmbajnë, shërbejnë si prova materiale, të cilat mund të ndihmojnë në zbardhjen e fakteve objekt hetimi. Për pretendimin e ngritur në ankim për cenimin e nenit 8 të KEDNJ-së, gjykata ka arsyetuar se ndërhyrja në rastin konkret është bërë në një procedim penal objekti i hetimit të të cilit ka të bëjë me fakte të rëndësishme penale dhe me interes të lartë për komunitetin, kurse në lidhje me pretendimin për cenimin e nenit 37 të Kushtetutës, ka arsyetuar se veprimi i kontrollit të banesës dhe sekuestrimit të sendeve është në përputhje me kufizimin e lejuar nga kjo dispozitë, në kushtet kur është urdhëruar nga gjyqtari i hetimeve paraprake dhe është miratuar nga prokurori në përputhje me nevojat e procedimit dhe normat e KPP-së (nenet 202-207 dhe 301). Sipas asaj gjykate, në këtë rast ka kufizim të së drejtës së pronës, por se ai është i parashikuar me ligj, është i nevojshëm dhe proporcional. Kundër këtij vendimi kanë paraqitur rekurs kërkuesit.

10. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-666, datë 11.04.2024, në dhomën e këshillimit, ka vendosur mospranimin e rekursit të kërkuesve, duke vlerësuar se në vendimmarrjet e kundërshtuara nuk konstatohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit material ose procedural me rëndësi për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore; nuk evidentohet mosrespektim ose zbatim i gabuar i ligjit procedural me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave; si dhe nuk rezulton që ato të jenë në kundërshtim me praktikën e Kolegjit Penal ose të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë. Sipas atij kolegji, vendimi i prokurorit për vleftësimin e sekuestros është i arsyetuar, proporcional dhe i bazuar në ligj, ku për sa i përket sekuestrimit të telefonit celular të kërkuesit Jamarbër Malltezi, arsyetohet se është i nevojshëm për hetimin, pasi në të mund të gjenden të dhëna me rëndësi, siç mund të jenë komunikimet me bashkëpunëtorë të mundshëm, dokumente etj., përveçse është pasur parasysh rreziku që mund të ndryshojnë ose të humbasin. Po kështu, edhe në lidhje me telefonin celular të shtetasës A.P. dhe sendet e sekuestruara në ambientet e kërkueses, shoqërisë “Studio Pustina” sh.p.k., është vlerësuar ekzistenca e rrezikut që ato sende dhe prova materiale që lidhen me veprën penale të mund të ndryshojnë ose humbasin. Po sipas Kolegjit Penal, vendimet e organit procedues dhe të gjykatave të posaçme janë në përputhje me ligjin material dhe atë procedural penal, nenin 8 të KEDNJ-së dhe nenin 37 të Kushtetutës, si dhe me vendimin njëses nr. 147, datë 23.12.2021 të Gjykatës së Lartë. Kolegji Penal ka vlerësuar se gjatë hetimeve parapake është prokurori ai që vlerëson dhe çmon rrugën e duhur për të vërtetuar akuzën dhe mënyrën e marrjes së provave sipas procedurës së parashikuar nga ligji procedural dhe, në bazë të rezultateve të hetimeve, vendos nëse sekuestrimi i një prove është apo jo më i nevojshëm, ndërkohë që GJKKO-ja e Apelit ka plotësuar arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë, duke saktësuar të gjitha pretendimet e kërkuesve dhe duke u dhënë përgjigje shteruese atyre, në interpretim të drejtë të ligjit procedural penal në raport edhe me praktikën e Gjykatës së Lartë, si dhe në respektim të së drejtës së kërkuesve për një proces të rregullt.

11. Në datën 06.08.2024 kërkuesit i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, sipas objektit të kërkesës. Në lidhje me afatin për shqyrtimin paraprak të çështjes, të përcaktuar në nenin 47, pika 1, të ligjit nr. 8577/2000, bazuar në nenet 15, pika 2 dhe 21, pika 1, të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese (*Rregullorja e Gjykatës*), në këtë afat nuk llogaritet periudha e lejes vjetore, sipas nenit 18, pika 1, shkronja “b”, të po këtij ligji.

12. Me vendimin e datës 01.11.2024 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Kjo e fundit, me vendimin e datës 19.11.2024, ka vendosur pranimin e kërkesës së një gjyqtari të Gjykatës për heqjen dorë nga shqyrtimi i kësaj çështjeje.

II

Pretendimet e kërkuësve

13. **Kërkuësit**, në mënyrë të përmbledhur, kanë pretenduar se u është cenuar:

13.1. *E drejta për proces të rregullt në drejtim të:*

13.1.1. *Standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimet gjyqësore të kundërshtuara janë haptazi të paarsyetuara dhe jo koherente. Vendimet përmbajnë të dhëna kontradiktore dhe gjykatat nuk u kanë dhënë zgjidhje të plotë dhe shteruese të gjitha pretendimeve të kërkuësve, ndërsa ato nuk kanë marrë parasysh provat dhe pretendimet dhe as nuk kanë analizuar provat e dosjes gjyqësore, duke arritur në përfundime haptazi të padrejta. Referuar paragrafit 29 të vendimit të Gjykatës së Lartë, edhe pse në parim arsyetohet se sekuestrimi i provave duhet të mos dalë jashtë objektit të hetimit, sikurse kërkuësit kanë pretenduar, ajo gjykatë nuk ka marrë në analizë pretendimet e tyre në lidhje me procedurën e ndjekur në rastin konkret, pra nëse provat e sekuestruara i shërbejnë hetimit, nëse procedura ka qenë në përputhje me kuadrin ligjor dhe nëse është respektuar proporcionaliteti midis hetimit dhe mbrojtjes së të drejtave të kërkuësve. Gjykata e Lartë nuk u ka dhënë përgjigje pretendimeve për zbatimin e nenit 208 të KPP-së dhe nëse disponimi i prokurorit plotëson standardet e një vendimi të arsytuar, nëse kërkohet ndërhyrje apo kontroll gjyqësor kur disponohet për sekuestrimin e pajisjeve telefonike, kompjuterike, laptop apo njësi kompjuterike dhe se në çfarë faze ndërhyr gjykata, si dhe nëse është zbatuar testi i proporcionalitetit në rastin konkret.

13.1.2. *Interpretimit dhe zbatimit të gabuar nga gjykatat të neneve 208-208/a të KPP-së dhe moszbatimit të vendimit njësuës të Kolegjit Penal nr. 147, datë 23.12.2021*, referuar të cilave sekuestrimi i të dhënave kompjuterike kryhet vetëm me vendim gjyqësor, ndërkohë që në rastin konkret sekuestrimi i aparatit celular dhe pajisjeve

e sistemeve kompjuterike apo të dhënave kompjuterike është bërë nga OPGJ-të dhe është vleftësuar i ligjshëm nga prokuroria. GJKKO-ja e Apelit nuk ka argumentuar se përse të dhënat që ndodhen në kompjuterët nuk janë të dhëna kompjuterike, ndërkohë që argumenti se një kompjuter i palidhur në rrjet është një mekanizëm i automatizuar nuk ka kuptim, pasi kompjuterët e sekuestruar në “Studion Pustina” kanë informacione konfidenciale me kredenciale për akses në disa programe, si dhe të dhëna që ruhen nga sekreti profesional apo tregtar. Sipas prokurorisë dhe gjykatave, neni 208/a i KPP-së zbatohet vetëm kur hetohet për krime kibernetike, ndërkohë që parashikimet e neneve 208 dhe 208/a të KPP-së nuk lidhen me llojin e veprës penale, por me intensitetin e ndërhyrjes dhe garancitë sipas nenit 208/a kanë të bëjnë me cenimin e jetës private edhe kur hetohet për vepra të tjera penale. Është detyrë e gjykatës dhe prokurorisë të përcaktojë se cilat janë konkretisht të dhënat ose sistemet kompjuterike që do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe çfarë synohet të provohet nëpërmjet vendosjes së sekuestros për to dhe nuk mundet kurrësi që të sekuestrohet një aparat celular apo sisteme kompjuterike pa u përcaktuar se çfarë të dhënash do të sekuestrohen konkretisht në to, pra nuk mund të ecet me parimin që të sekuestrohen dhe më pas të shihet se çfarë mund të gjendet, pasi në këtë mënyrë cenohet rëndë thelbi i së drejtës së mbrojtur nga neni 8 i KEDNJ-së. Bazuar në nenin 151, pika 1, të KPP-së, këto prova të marra në shkelje të ndalimeve të parashikuara nga ligji nuk mund të përdoren.

13.2. *Ndërhyrja është bërë në kundërshtim me nenet 17 dhe 36 e 37 të Kushtetutës dhe nenin 8 të KEDNJ-së, për shkak të ushtrimit të kontrollit dhe sekuestrimit të pajisjeve elektronike që përmbajnë të dhëna që nuk lidhen me subjektin dhe objektin e hetimit.* OPGJ-të me procesverbalin e datës 21.10.2023 kanë sekuestruar aparat celular të kërkuesit Jamarbër Malltezi, kurse në datën 22.10.2023 kanë sekuestruar në mjediset e kërkueses, shoqërisë “Studio Pustina” sh.p.k., një telefon të markës *Blackberry*, dy pajisje *hard disc*, dy laptopë dhe një njësi qendrore PC, pra sisteme kompjuterike dhe pajisje mbajtëse të të dhënave kompjuterike që nuk janë objekt sekuestrimi dhe nuk kanë asnjë lidhje me objektin e hetimit të organit të akuzës. Më konkretisht, në njësinë qendrore në përdorim të punonjësës P.B. ndodhet programi Financa 5 dhe mbahen

kontabilitetet e klientëve të kërkueses; laptopi *HP* është pronë e një shoqërie tjetër, kliente e kërkueses, dhe nuk përmban informacion për shoqërinë “Homeplan” sh.p.k.; në laptopin *Fujitsu* është programi i kontabilitetit Financa 4 ku janë të regjistruara, përveç të dhënave të shoqërisë “Homeplan” sh.p.k., edhe bilancet e disa shoqërive të tjera, kliente të kërkueses; pajisjet e tjera kanë programe dhe informacione të klientëve të tjerë të kërkueses, pa të cilët e gjithë puna pezullohet, duke dëmtuar biznesin e saj dhe të vetë këtyre klientëve. Disa pajisje janë sekuestruar edhe me procesverbalin e datës 28.04.2023, u janë nënshtruar ekspertimit dhe janë kthyer, çka tregon se sekuestrimi i tyre nuk i shërben vërtetimit të fakteve dhe pasojave të ardhura në rastin konkret. Në kompjuterë ka edhe të dhëna konfidenciale me kredenciale për akses në programet *e-albania*, *selfare*, *e-filing*, ose llogari bankare, posta elektronike të klientëve të kërkueses etj., të cilat nuk kanë lidhje me objektin dhe subjektin e hetimit.

- 13.3. Edhe në lidhje me sekuestrimin e celularit të kërkuesit Jamarbër Malltezi, në vendimin e gjykatës, në procesverbal dhe më pas në vendimin e prokurorit nuk është përcaktuar se çfarë të dhënash duhet të sekuestrohen dhe se përse duhet të mbahet telefoni ku ka të dhëna të jetës private dhe familjare të kërkuesit, të cilat nuk lidhen me faktin për të cilin po heton prokuroria. Gjykatat nuk kanë mbajtur parasysh se aparati celular mund të sekuestrohet si provë materiale nëse organi procedues jep arsye të mjaftueshme për lidhjen me faktin penal në hetim, por ekstraktimi i të dhënave që ndodhen në të nuk mund të kryhet pa vendim gjyqësor, duke qenë se këto të dhëna përbëjnë “korrespondencë”, e cila mbrohet në mënyrë të posaçme nga neni 36 i Kushtetutës dhe neni 8 i KEDNJ-së. Edhe neni 209 i KPP-së parashikon se sekuestrimi i korrespondencës vendoset nga gjykata, duke parashikuar autoritetin gjyqësor si kompetent për të shqyrtuar përshtatshmërinë e masës së kërkuar nga prokuroria, pra këqyrja apo sekuestrimi i korrespondencës që ndodhet në telefon, me nevojat e hetimit për të cilin është kërkuar. Sipas nenit 299 të KPP-së, Policia Gjyqësore mund të veprojë vetëm në kushtet e urgjencës, që, në rastin konkret, nuk ka ekzistuar, pasi kjo rrethanë nuk është cituar në aktet e sekuestrimit. Sekuestrimi i aparateve telefonike është kryer me nismë nga OPGJ-të për të dy kërkuesit, veprim që është miratuar nga prokuroria, duke u konsideruar si sekuestrim i një prove

materiale. Duke qenë se kontrolli dhe sekuestrimi janë të kundërligjshme, ndërhyrja nuk është proporcionale dhe ka cenuar të drejtën për jetë private, pasi sekuestrimi nuk është vendosur nga gjykata, por është kryer me nismë nga prokuroria, pavarësisht se sendet e sekuestruara shërbejnë për ruajtjen e korrespondencës. Në aktet e sekuestrimit nuk është arsyetuar dhe justifikuar ndërhyrja dhe kufizimi i së drejtës, pra se përse sekuestrimi i aparatit celular apo i të dhënave, apo sistemeve kompjuterike është i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes kur në disa nga ato nuk ka të dhëna që lidhen me subjektin dhe objektin e hetimit, nuk është përcaktuar as se cilat të dhëna apo sisteme kompjuterike do t'i nënshtrohen sekuestrimit dhe se çfarë synohet të provohet përmes tij, si dhe nuk janë përcaktuar modalitetet për sekuestrimin e sistemeve dhe të dhënave kompjuterike në mënyrë që të sekuestrohen vetëm ato të përcaktuara shprehimisht.

- 13.4. Kërkesja, shoqëria “Studio Pustina” sh.p.k., jo vetëm që nuk është subjekt në hetim, por për shkak të këtij sekuestrimi asaj i janë dëmtuar interesat ekonomikë dhe reputacioni në lidhje me klientët. OPGJ-të kanë sekuestruar edhe pasqyra financiare të klientëve të tjerë të kësaj kërkueseje, për të cilat nuk ka asnjë të dhënë si dhe përse kanë lidhje me procedimin penal apo me personat nën hetim.

III

Vlerësimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve

A. Për legjitimitimin e kërkesve

14. Çështja e legjitimitimit është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

15. Në lidhje me legjitimimin *ratione personae*, sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, individi është subjekt i cili mund të paraqesë ankim kushtetues individual vetëm për çështje që lidhen me interesat e tij të drejtpërdrejta, duke provuar se është cenuar në të drejtat e tij kushtetuese, pra se është viktimë e një shkeljeje dhe se pasojat nga akti i kundërshtuar janë të drejtpërdrejta dhe reale për të. Kjo do të thotë se kërkuesi duhet të provojë legjitimimin e tij si në aspektin procedural, ashtu edhe në atë substancial (*shih vendimet nr. 65, datë 30.11.2023; nr. 44, datë 26.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kërkuesit kanë qenë palë në procesin gjyqësor të kundërshtuar, të vënë në lëvizje mbi bazën e ankimeve të tyre kundër vendimeve të Prokurorisë së Posaçme për vleftësimin si të ligjshëm të sendeve të sekuestruara. Po kështu, në drejtim të provueshmërisë së interesit në çështjen konkrete, kërkuesit kanë provuar se pasojat e pretenduara, negative, të drejtpërdrejta dhe reale në të drejtat e tyre kushtetuese për jetë private dhe familjare dhe paprekshmërinë e banesës, ashtu si dhe të drejtën për një proces të rregullt, kanë ardhur nga vendimet e kundërshtuara dhe se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata do të mund të rivendoste këto të drejta të pretenduara të shkelura. Për rrjedhojë, kërkuesit legjitimohen *ratione personae* për t’iu drejtuar Gjykatës.

17. Në lidhje me *kriterin e shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, mbrojtja kushtetuese ka një funksion subsidiar, që do të thotë se ajo mund të kërkohet vetëm për një vendim përfundimtar, të çfarëdolloj forme që përmbyll procesin gjyqësor, pasi individi ka shteruar mjetet dhe rrugët e tjera ligjore. Cenimi i të drejtave themelore, përfshirë atë për një proces të rregullt ligjor, mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pasi të shterohen të gjitha mundësitë e ofruara nga sistemi i apelineve (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18, datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*).

18. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se objekt kundërshtimi janë vendimet gjyqësore të të tria shkallëve të gjykimit, me të cilat është rrëzuar ankimi i kërkuesve ndaj vendimit të prokurorisë për vleftësimin e ligjshëm të sendeve të sekuestruara, duke mbetur kështu praktikisht në fuqi masat e sekuestros (provuese) mbi sendet. Nisur nga fakti se Gjykata i ka përfshirë në juridiksionin e saj këto vendime, të cilat ndonëse me karakter të përkohshëm dhe që nuk vendosin për themelin e çështjes, ndërhyjnë në të drejtat kushtetuese individuale (*shih vendimet nr. 29, datë 16.04.2024; nr. 18 datë 19.03.2024 të Gjykatës Kushtetuese*), Mbledhja e Gjyqtarëve, me shumicë votash¹,

¹ Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për mosplotësimin e këtij kriteri legjitimimi, me arsyetimin se vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare, në kuptim të nenit 131, shkronja “f”, të Kushtetutës, ndaj nuk

çmon se kërkuesit i kanë shteruar pretendimet e tyre në formë dhe në substancë përpara gjykatave të zakonshme, për rrjedhojë ata kanë përmbushur edhe këtë kriter legjitimimi për vënien në lëvizje të gjykimit kushtetues.

19. Kërkuesit legjitimohen edhe *ratione temporis*, në kuptim të përmbajtjes së nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, pasi vendimi më i fundit në kohë i kundërshtuar, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, mban datën 11.04.2024, ndërsa kërkesa është paraqitur në këtë Gjykatë në datën 06.08.2024, pra brenda afatit 4-mujor.

20. Për sa i takon legjitimitit *ratione materiae*, kërkuesit kanë pretenduar cenimin e së drejtës për proces të rregullt në drejtim të standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore dhe mënyrës së interpretimit të neneve 208 dhe 208/a të KPP-së, ashtu edhe zbatimit të vendimit njësuës nr. 147, datë 23.12.2021 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si dhe cenimin e neneve 36 e 37 të Kushtetutës dhe nenit 8 të KEDNJ-së, në drejtim të lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe kontrollit të banesës, si dhe të së drejtës për jetë private e familjare, për shkak të mosrespektimit të kriterëve të kufizimit sipas nenit 17 të Kushtetutës.

21. Në lidhje me këtë kriter të legjitimitit, qëndrimet e gjyqtarëve u ndanë në drejtim të përmbushjes së kërkesës që pretendimet e ngritura në ankimin kushtetues të mos jenë haptazi të pabazuara, si një nga kriteret që verifikohet për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në kuptim të nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 23 të Rregullores së Gjykatës.

22. Sipas njërit qëndrim², kërkuesit nuk legjitimohen *ratione materiae*, për sa kohë që pretendimet e tyre janë haptazi të pabazuara. Në rastin në shqyrtim, kërkuesve u janë kufizuar të drejtat substanciale të jetës private, banesës dhe korrespondencës, të garantuara nga nenet 36 dhe 37 të Kushtetutës; kufizimi është me ligj, në kuptimin që është vendosur me vendim gjyqësor sipas rasteve të parashikuara nga ligji procedural penal; kufizimi është vendosur për qëllimin legjitim të mbarëvajtjes së procedimit penal; si dhe është proporcional në drejtim të nevojës, përshtatshmërisë dhe ashpërsisë. Referuar vendimeve gjyqësore të kundërshtuara, gjykatat e faktit kanë shqyrtuar pretendimet e parashtruara në ankimet e kërkuesve si në lidhje me cenimin e të drejtave kushtetuese, ashtu dhe mënyrën e interpretimit të neneve 208 dhe 208/a të KPP-së apo të dispozitave procedurale ku janë bazuar veprimet e OPGJ-ve dhe të prokurorëve të posaçëm, duke

mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues, qëndrim ky i mbajtur dhe i elaboruar në mendimet paralele të vendimit nr. 18, datë 13.03.2024 të Gjykatës, si dhe në vendime të tjera të kësaj natyre në vijim.

² Gjyqtaret Marsida Xhaferllari dhe Fiona Papajorgji votuan për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

u dhënë përgjigje shteruese atyre. Edhe Gjykata e Lartë, pasi ka shqyrtuar pretendimet e parashtruara në rekurs, në analizë të parashikimeve të dispozitave kushtetuese, ashtu edhe të përfundimeve të saj në vendimin njësuës në drejtim të garancive që burojnë nga neni 208 i KPP-së, të cilat zbatohen, sipas saj, edhe në rastin e nenit 208/a të po këtij kodi, i ka gjetur shkaqet e ngritura nga kërkuesit të pabazuara dhe arsyetimin e gjykatës së apelit të drejtë, si dhe të bazuar në ligj. Për rrjedhojë, bazuar në përmbajtjen e dispozitave procedurale të zbatueshme, nuk rezulton që interpretimi që u kanë bërë atyre gjykatat e zakonshme të jetë i tillë që të konsiderohet dukshëm arbitrar apo i paarsyeshëm, me pasojë cenimin e të drejtave kushtetuese të kërkuesve në kundërshtim me kriteret e nenit 17 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, pretendimet e kërkuesve janë haptazi të pabazuara, për sa kohë që nuk është arritur të argumentohet në aspektin kushtetues cenimi i të drejtave të tyre substanciale nga vendimmarrja e kundërshtuar e gjykatave të zakonshme.

23. Sipas qëndrimit tjetër³, pretendimet e kërkuesve për cenimin e neneve 36 dhe 37 të Kushtetutës, në drejtim të lirisë dhe fshehtësisë së korrespondencës dhe kontrollit të banesës, ashtu edhe nenit 8 të KEDNJ-së, në drejtim të së drejtës për jetë private e familjare, nuk janë haptazi të pabazuara. Kjo qasje bazohet në dallimin që ekziston në rastin konkret mes sekuestrimit të sendeve në kuptim të së drejtës së pronës private dhe sekuestrimit të korrespondencës dhe mjeteve të komunikimit, liria dhe fshehtësia e së cilës është e garantuar kushtetutshmërisht (neni 36 i Kushtetutës) dhe që, nga ana tjetër, është një nga elementet e së drejtës për jetë private dhe familjare. Për rrjedhojë, ndërsa në drejtim të së drejtës së pronës nuk konstatohet shkelje në procesin për sekuestrimin e sendeve dhe dokumenteve, shkelja në rastin konkret ka të bëjë me sekuestrimin e të dhënave që ndodhen në sendet e sekuestruara, që mund të bëhet vetëm nga gjykata, vetëm me vendim gjyqësor paraprak dhe vetëm duke përcaktuar llojin dhe natyrën e të dhënave që nevojitet të sekuestrohen, periudhën kohore së cilës i përkasin dhe arsyet e argumentuara për qëllimin e këtij sekuestrimi në kuptim të lidhjes së tyre me objektin dhe subjektin e hetimit. Sipas nenit 209 të KPP-së, kur gjykata ka arsye të bazuara të mendojë se në zyrat postare ose telegrafike gjenden letra, letra me vlerë, zarfe, pako, telegrame dhe objekte të tjera të korrespondencës që janë dërguar nga i pandehuri ose që i drejtohen atij, qoftë edhe me emër tjetër ose nëpërmjet një personi tjetër, vendos sekuestrimin e tyre. Megjithatë, sot koncepti i korrespondencës nuk është i njëjtë me atë në kohën e hartimit të këtyre dispozitave dhe ai ka

³ Gjyqtarët Holta Zaçaj, Sandër Beci dhe Genti Ibrahim i votuan për kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

evoluar, duke u interpretuar se garancia e paprekshmërisë së korrespondencës shtrihet ndaj çdo mjeti që evolucioni teknologjik vë në dispozicion për qëllime komunikimi, përfshirë ato elektronike dhe informatike. Sipas Gjykatës Kushtetuese të Italisë, lidhja e ngushtë e lirisë dhe fshehtësisë së komunikimit me thelbin e vlerave të personalitetit sjell një kufizim të veçantë interpretues, që synon t'i japë asaj lirie, për aq sa është e mundur, një domethënie të gjerë. Duke qenë se “korrespondenca” është një koncept gjerësisht gjithëpërfshirës, i aftë për të përfshirë çdo komunikim të mendimit njerëzor (ide, synime, ndjenja, të dhëna, lajme) midis dy ose më shumë personave të përcaktuar, mbrojtja kushtetuese që u siguron të gjithëve lirinë dhe fshehtësinë e “korrespondencës dhe çdo forme tjetër komunikimi”, pavarësisht nga karakteristikat e mjetit teknik të përdorur për qëllime të transmetimit të mendimit, e ka hapur tekstin kushtetues ndaj shfaqjes së mundshme të mjeteve dhe formave të reja të komunikimit, ku përfshihet edhe posta elektronike dhe komunikimi përmes *Whatsapp*-it (*shih vendimin nr. 170/2023 të Gjykatës Kushtetuese të Italisë*). Edhe GJEDNJ-ja nuk ka pasur hezitim për të përfshirë në mbrojtjen e nenit 8 të KEDNJ-së, aty ku i referohet “korrespondencës”, edhe mesazhet elektronike e mesazhet e dërguara dhe të marra nëpërmjet internetit (*shih Barbulescu kundër Rumanisë [DhM], datë 05.09.2017, §§ 72 e 74; Copland kundër Mbretërisë së Bashkuar, datë 03.04.2007, § 41*), si dhe SMS-të (*shih Saber kundër Norvegjisë, datë 17.12.2020, § 48*). Çdo qëndrim tjetër do të ishte i papranueshëm, për sa kohë që do e kufizonte këtë mbrojtje, duke e asgjësuar në thelb atë. Nga ana tjetër, një shkelje e tillë, për nga natyra e saj, konsiderohet se nuk mund të riparohet në një fazë të mëvonshme të procesit, për sa kohë që prekja e korrespondencës përmes një procedure të paligjshme e bën të pavlefshëm nga pikëpamja kushtetuese çdo veprim dhe procedurë tjetër të mëpasshme, çka do të thotë se pasojat e kësaj shkeljeje është e pamundur të korrigjohen. Në këtë kuptim, u takonte gjykatave të zakonshme të vlerësonin këtë proces në këtë këndvështrim, duke u dhënë përgjigje të arsyetuar edhe pretendimeve të kërkuesve për cenim të lirisë së korrespondencës dhe të së drejtës për jetë private e familjare. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, duke pasur parasysh të drejtat e pretenduara të cenuara dhe referuar natyrës dhe thelbit të pretendimeve të parashtruara nga kërkuesit, ishte i nevojshëm kalimi i çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në mënyrë që Gjykata të jepte një përgjigje përfundimtare në lidhje me to, pra nëse ndërhyrja në rastin konkret ishte arbitrare dhe nëse ajo plotësonte kriteret kushtetuese të kufizimit.

24. Sipas nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000, vendimi për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare nga Mbledhja e Gjyqtarëve merret me shumicën e votave dhe sipas

nenit 25, pika 5, të Rregullores së Gjykatës, vendimi i Mbledhjes së Gjyqtarëve për kalimin ose moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare merret me shumicën e votave të gjyqtarëve që marrin pjesë në mbledhje. Po sipas kësaj dispozite të fundit, moskalimi vendoset në rast se nuk plotësohet qoftë edhe njëri nga kriteret e pranueshmërisë.

25. Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se qëndrimi i mësipërm i gjyqtarëve për mosplotësimin e kriterit të legjitimitit *ratione materiae* i është bashkuar në drejtim të plotësimit kumulativ të të gjitha kriterëve të legjitimitit, qëndrimin të gjyqtarëve për mosplotësimin e kriterit të shterimit të mjeteve juridike, sipas të cilit vendimet objekt kërkese janë jopërfundimtare, ndaj nuk mund t'i nënshtrohen gjykimit kushtetues. Sipas këtij qëndrimi⁴, duke evidentuar se masa e sekuestros për qëllime prove në rastin konkret, ndërsa i ka hequr zotërimin e sendeve personave të cilëve u përkasin, në mungesë të veprimeve të tjera në lidhje me to, ka ndërhyrë vetëm në të drejtën e tyre të pronës, për rrjedhojë vendimet objekt kundërshtimi janë jopërfundimtare, pasi masa kufizuese në fjalë është e përkohshme dhe nuk ka masën e duhur të autonomisë nga procesi përfundimtar. Në referim të dispozitave të KPP-së, konkretisht të Pjesës së Parë, Titulli IV (Provat), Kreu III (Mjetet e kërkimit të provës), Seksioni II (Kontrollet) dhe Seksioni III (Sekuestrimet), por edhe të Pjesës së Dytë (Hetimet paraprake), Kreu IV (Veprimet me iniciativë të Policisë Gjyqësore), masa e sekuestros së sendeve për qëllime prove vendoset kur ato lidhen me veprën penale dhe janë të domosdoshme për vërtetimin e fakteve, ndërkohë që sendet e sekuestruara mund të kthehen kur mbajtja e sekuestros nuk është e nevojshme. Një masë e tillë kufizuese është e domosdoshme për mbarëvajtjen e procesit penal në lidhje me hetimin dhe të provuarin e një vepre penale. Megjithatë, kjo masë nuk përcakton themelin e çështjes dhe, si e tillë, nuk mund të ketë mbrojtje kushtetuese. Pjesë e procesit të themelit është edhe kalimi ose jo në favor të shtetit (konfiskimi) i sendeve të sekuestruara për qëllime prove, vendim i cili ka aftësinë të ndryshojë dhe të riparojë në masën e duhur efektet që sekuestrimi ka sjellë. Masa e sekuestros provuese synon fiksimin dhe ruajtjen e sendeve të lidhen me veprën penale, duke parandaluar ndryshimin ose humbjen e tyre për shkak të disponimit të lirë. Përshtatshmëria e një mase të tillë vlerësohet nga prokurori, por edhe nga gjykatat e zakonshme, të cilët, në çdo kohë, në varësi të dinamikës së procesit penal, mund të disponojnë për kthimin e sendeve të sekuestruara për qëllime prove, qoftë kur kjo masë është vendosur në mungesë të kushteve ligjore, ashtu dhe kur mbajtja e saj bëhet e panevojshme, çka do të thotë se ligji procedural penal i garanton individit mjete mbrojtëse ndaj masës së sekuestrimit

⁴ Gjyqtarët Ilir Toska dhe Marjana Semini votuan për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.

provues, efektiviteti i të cilave nuk mund të vihet në dyshim *a priori*. Për rrjedhojë, sipas këtij qëndrimi, përfshirja në juridiksionin kushtetues të masës së sekuestros provuese do të passillte mbivendosjen e këtij juridiksioni me atë të gjyqësorit të zakonshëm, të cilit i përket ekskluzivisht vlerësimi i përshtatshmërisë së vendosjes dhe i mbajtjes së kësaj mase, ndërsa ai disponon të gjitha mjetet për të krijuar bindjen për lidhjen e sendit të sekuestruar për qëllime prove me veprën penale që hetohet, si dhe për mundësinë e ndryshimit dhe të humbjes së tij për shkak të disponimit të lirë.

26. Për sa më sipër, në situatën që shumica e gjyqtarëve kanë votuar se në rastin konkret nuk plotësohen në mënyrë kumulative kriteret e legjitimitit, pavarësisht shkakut mbi të cilin e kanë mbështetur këtë qëndrim, Mbledhja e Gjyqtarëve vëren se është arritur shumica e kërkuar për moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare, në kuptim të përmbajtjes së nenit 31/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 25, pika 5, të Rregullores së Gjykatës.

27. Në përfundim, Mbledhja e Gjyqtarëve çmon se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore paraprake për pranimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Mbledhja e Gjyqtarëve, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pikat 1 dhe 2, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe neneve 23 e 25 të Rregullores për Procedurat Gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.